

Nr.regj.30758/12

GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,me gjyqtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Nim Thaqi,duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Isa Qazim Smajli,nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 5.6 paragrafi 1.3,neni 9,i sanksionuar me nenin neni 17 paragrfi 1.3 të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lartë publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar me Nr.04-L-050,e në bazë të nenit , 73,74,195,si dhe konform nenit 198.al.8 të LMK-së, me dt .18.06.2013 merrë:

A K T V E N D I M

Pezullohet procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit Isa Qazim Smajli nga Prishtina,për kundërvajtje nga neni 5.6 paragrafi 1.3,neni 9 i sanksionuar me nenin 17. paragrafi 1.3 të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lartë publik dhe deklarimin,prejardhjen dh kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar nr.04/L-050, e konform nenit 198.al.1 pika 8, të LMK-së sepse nuk ka prova të mjaftueshme se i pandehuri ka bërë kundërvajtjet e përshkruara në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ligji me nr.4/L-50,Ushtruesit e detyres nuk i obligon që ta deklarojnë pasurinë në Agjencioni Kunder Korrupsionit.

Shpenzimet të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palës dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni kundër korrupsionit-në Prishtinë,me kërkesën nr,01-2498/12 të parashtruar gjykatës me dt.30.07.2012,me të cilën i propozohet gjykatës hapjen e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të lartëcekur,për kundërvajtje nga neni i lartëcekur nga se dyshohet se i pandehuri nuk e ka bërë deklarimin e pausris me rastin e emrimit ushtrues detyre të drejtorit. Gjyqtari mori në pyetje të pandehurin i cili në deklaratën e tij thekson se unë nga kryeshefi ekzekutiv kah mesi i nëntorit 2011,jam emrue Ushtrues i Detyres së Drejtorit të Telekomit të Kosovës,kah mesi i dhjetorit më kanë shkarkue nga kjo detyrë,ku më pastaj pas një jave prap më kanë emrue Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Telekomit të Kosovës.Unë nuk kam qenë i njohtuar se jam i obliguar ta lajmroj pasurinë nga zyrtari kontaktues.Se jam i obliguar ta lajmroj pasurinë më ka njohtue Agjencioni Kunder Korrupsion,të cilën gjë edhe e kam bërë.

Gjyqtari mori në pyetje Qenan Qerimin pika kontaktuese e AKK_së,në cilësin e deshmitarit,i cili deklaroi se e ka njohtuar me imeill Isa Smajlin,se është i obliguar ta lajmroj pasurinë.

Gjithashtu gjyqtari ka ndegjyuar ushtruesin e kërkesës në cilësin e deshmitarit Agron Behramin,i cili në deklaratën e tij theksoj "Ne si Agjenci mendojm se edhe ushtruesit e detyrës janë të obliguar ta deklarojnë pasurin,pasi që janë bartës të të drejtave dhe detyrave sikurse me qenë të emruar në formë të rregullt"Edhe pse ligji nuk e përfshin këtë kategori,por me siq është e rregulluar me ligje tjera,kështu që mendoj se edhe këta persona janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë.

Gjyqtari pas degjimit të pandehurit,deshmitarit,ushtruesit të kërkeses dhe shqyrtimit të shkrasave të lëndes, mori vendim konform nenit neni 198.al.1 pika 8 e LMK-së,sepse nuk ka prova të besueshme se i pandehuri e ka krye një kundërvajtje të till sepse dispozitat ligjore të Ligjit me nr.04/L-50,nuk e parashohin që kategorija e ushtruesve të detyres janë të obliguar ta deklarojnë pasurin,konkretisht neni 3 i këtij ligji e specifikon se kush është i obliguar ta deklarojë pasurinë. Duke u bazuar në të gjitha këto gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi palët mund të ushtrojnë ankesë Gjykatës së Apelit-Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet kësaj Gjykate pa taksa.

Gjyqtari

Murat Paçarada

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA E DREJTISE KURRUPSIONIT	
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION	
Dok. 03-1980/13	
Dok. 02-07-2013	
Nr. 01	
Prishtine	